



(DRAFT)
PLANI I PUNËS I EKIT
PËR TË DREJTAT E FËMIJËS
KOMUNA GJAKOVË
2024-2026

Lista e shkurtesave

AK	Asambleja Komunale
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
DKA	Drejtoria e Arsimit
DBF	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
EDF	Ekipi për të Drejtat e Fëmijës
FKZH	Forumi Kosovar për Zhvillim (KDF)
KDF	Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës
KKGJ	Kuvendi Komunal i Gjakovës
KVRL	Këshilli I Veprimit Rinor Lokal
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MKRS	Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport
OJQ	Organizata Joqeveritare
QPS	Qendra për Punë Sociale
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e fëmijëve

DOKUMENTET E REFERIMIT

-  Ligji Nr. 06/L-084 Për Mbrojtjen e Fëmijës¹
-  UA (Qrk) 06/2020 për Themelimin dhe Funksonimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës²,
-  Profili i Komunave të Kosovës, MAPL, 2021³
-  Plani Zhvillimor Komunal për Komunën e Gjakovës (2021-2029)⁴
-  Projekt Harta Zonale e Komunës së Gjakovës, (2022-2030), ⁵
-  Plani i Zhvillimit Institucional i Kujdesit Parësor Shëndetësor të Gjakovës (2021-2024), ⁶
-  Plani i Punës së Komisionit për Edukim dhe Promovim Shëndetësor në Rritjen e Shkallës së Imunizimit të Rregullt, me theks yë veçantë tek Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, Unicef, (2022-2024),
-  Plani Zhvillimor i Arsimit (2017-2021), ⁷
-  Hartëzimi i Shërbimeve të Zhvillimit në Fëmijërinë e Hershme në Kosovë, Unicef, (Dhjetor, 2020),
-  Profili i Komunave, UNICEF
-  Strategjia për Rininë, MKRS, (2019-2023)⁸,
-  Vizitat sistematike të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme të ulta, Klasa I, V dhe IX në komunën e Gjakovës, (QKMF, 2023).
-  Udhëzues për Krijimin e Komunës mike për Fëmijës, Unicef dhe KGJ, (2017-2021),
-  Strategjia dhe Plani i Veprimit për Komunën Mike, KGJ (2012-2021
-  Strategjia e Bashkimit Evropian për të Drejtat e Fëmijës, (2021)⁹

¹ <https://qzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

² <https://qzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61596>

³ <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/09/1.Profili-i-komunave-shqip.pdf>

⁴ <https://kk.rks-gov.net/gjakove/wp-content/uploads/sites/2/2020/12/Draft-Plani-Zhvillimor-Komunal-2021-2029.pdf>

⁵ <https://kk.rks-gov.net/gjakove/wp-content/uploads/sites/2/2023/02/Draft-Harta-Zonale-e-Komunes-Shqyrtimi-Publik.pdf>

⁶ <https://kk.rks-gov.net/gjakove/wp-content/uploads/sites/2/2020/12/Plani-i-Zhvillimit-Institucional-i-sistemit-te-Kujdesit-Paresor-Shendetesor-KPSH-te-Komunes-se-Gjakoves-nr-29854.pdf>

⁷ <http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2018/02/Plani-Zhvillimor-i-Arsimit-GJAKOVE-ALB.pdf>

⁸ https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Strategjia_per_Rini-2019-2023.pdf

⁹ https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/IP_21_1226

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
Hyrje	5
 Komuna e Gjakovës – Profili.....	6
MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËS NË KONTEKSTIN GLOBAL, NACIONAL DHE LOKAL	7
METODOLOGJIA DHE PROCESI	9
ANALIZA E SITUATËS DHE TREGUESIT SOCIAL.....	10
 Arsimi.....	10
 Shëndetësia.....	12
 Mirëqenia Sociale.....	13
 Kultura, Rinia dhe Sporti.....	14
 Mjedisi dhe hapësirat e gjelbra.....	15
 Ekipi për të Drejtat e Fëmijës.....	16
MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E PLANIT TË VEPRIMI.....	17
Objektivat Strategjike.....	18
 1. Përmirësimi i mbulueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore për nëna dhe fëmijë	19
 2. Përmirësimi i mbrojtjes, sigurisë dhe mirëqenies sociale.....	20
 3. Zhvillimi i një sistemi arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës.....	20
 4. Ofrimi i programeve të edukimit jo-formal, sportit, rekreacionit dhe mbrojtjes së mjedisit.....	21
 5. Fuqizimi i mekanizmit komunal për të Drejtat e Fëmijës.....	22
ORGANIZIMI, ZBATIMI DHE PËRGJEGJËSIA.....	23
BURIMET FINANCIARE	23
PËRKUFIZIMET	24
SHTOJCAT.....	24

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Si pasojë e globalizimit, ndryshimeve socio-ekonomike dhe ndryshimeve klimatike çdo ditë e më shumë paraqiten sfida të cilat kanë ndikim direkt në cilësinë e jetës së individit. Mirëqenia e fëmijës garanton pikën fillestare të progresit të qëndrueshëm në përmirësimin e formimit të kapitalit njerëzor. Si përfundim, të drejtat e fëmijëve janë thelbësore për të krijuar një shoqëri të barabartë dhe gjithëpërfshirëse.

Për t'u dëgjuar dhe për t'ju dhënë pesha e duhur pikëpamjeve të të drejtave të fëmijës, ata duhet të respektohen në mënyrë sistematike dhe të përfshihen në të gjitha proceset e vendimmarrjes. Fuqizimi dhe pjesëmarrja e tyre duhet të jetë thelbësore në strategjitë dhe programet e kujdesit dhe mbrojtjes së fëmijëve.

Komuna e Gjakovës, si një nga objektivat strategjike të saj ka përgjegjësinë në implementimin e politikave dhe përfshirjen në programe që do t'i ofrojë kushtet optimale në fëmijëri, duke marrë të gjitha masat që asnjë fëmijë të mos mbetet prapa dhe ku interesat më të larta të fëmijës paraprijnë në planifikim, vendimmarrje dhe ekzekutim në të gjitha nivelet e komunës.

Në funksion të arritjes së këtij objektiivi Komuna e Gjakovës e ka themeluar Ekipin për të Drejtat e Fëmijëve me dt. 24.08.2022 duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale¹⁰, si dhe Udhëzimin Administrativ (Qrk) Nr. 06/2022 për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës¹¹.

Nën mbikqyrjen e MAPL në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë dhe me mbështetjen e UNICEF-it në Kosovë, EDF ka hartuar Planin e Punës të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës.

Hartimi i këtij Plani të Punës dhe temat e përfshirë në të janë diskutuar gjatë punëtorive të EDF si dhe komunikimit të rregullt mes drejtorive përgjegjëse dhe zyrës së UNICEF-it si mbështetës të jashtëm. Ekipi i hartimit të Planit të Punës ka vendosur që të përcaktohen dhe harmonizohen objektiva bazuar në nevojat, përgjegjësitë dhe kompetencat në nivel lokal. Si përfundim qëllimet dhe objektivat do të ndahen sipas fushave:

-  Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale,
-  Arsimi dhe Edukimi i Hershëm,
-  Kultura, Rinia dhe Sporti,
-  Mjedisi dhe Hapësirat e Gjelbra,
-  Përgjegjësitë e EDF (Kordinimi, funksionimi, implementimi, raportimi dhe monitorimi).

Plani i Punës përfshin periudhën 3 vjeçare 2024-2026. Zbatimi i planit dhe i objektivave do të jetë nën përgjegjësinë e secilës drejtori bazuar në strategjitë dhe planet e tyre të veprimit dhe brenda kornizave të kompetencave lokale.

Përfitues të këtij plani do të jenë fëmijët nga 0-18 vjeç me theks të veçantë duke ofruar kushte të barabarta për fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët e marginalizuar, fëmijë dhe të rinjë me vështirësi në të nxënë si dhe probleme me shëndetin mendor, fëmijët e abuzuar dhe fëmijët e komuniteteve.

¹⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

¹¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61596>

Hyrje

Plani i punës së Ekipit për të Drejtave të Fëmijës është një dokument i cili është hartuar nga EDF mbështetur nga zyra e UNICEF në Kosovë dhe shërben si udhërrëfyes për KKGJ dhe të gjithë mekanizmat lokal. Ky plan krijon vazhdimësi të dokumentit ‘Gjakova-Komunë Mike për Fëmijët, 2017-2021’.

Fëmijët janë një kategori e veçantë, të cilët për shkak të moshës dhe pjekurisë së tyre, të drejtat e tyre i realizojnë me mbështetjen e të rriturve prandaj Komuna e Gjakovës në pajtueshmëri të plotë me udhëzimet nga MAPL dhe legjislacionin në fuqi ka themeluar EDF duke qenë ky një hap për sigurimin e funksionalizimit të mekanizmit komunal për të drejtat e fëmijës.

Fushat prioritare të këtij plani të punës do të jenë:

- a. Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës: Sigurimi i një arsimi cilësor dhe të qasshëm për të gjithë fëmijët, përfshirë ndihmë për fëmijët me nevoja të veçanta dhe për ata që janë në rrezik të largimit nga shkolla.
- b. Mbrojtja nga dhuna dhe keqtrajtimi: Parandalimi dhe luftimi i çdo forme të dhunës dhe keqtrajtimit ndaj fëmijëve, duke përfshirë masa për ndalimin e dhunës në familje, shkolla dhe komunitet.
- c. Mbrojtja shëndetësore dhe sociale: Përmirësimi i qasjes në kujdes shëndetësor për fëmijët, përfshirë vizitat peri/post natale në institucion, vizitat në shtëpi, imunizimi, kujdes për sëmundje të ndryshme dhe shëndet mendor. Gjithashtu, garantimi i mbështetjes sociale për fëmijët në nevojë dhe gjithëpërfshirje në sistemin shëndetësor dhe mbrojtje sociale duke synuar zvogëlimin e varfërisë dhe ngritur mirëqenien e fëmijës.
- d. Zhvillimi kulturor dhe artistik: Sigurimi i mundësive për fëmijët që të marrin pjesë në aktivitete kulturore, artistike dhe rekreative që ndihmojnë në zhvillimin e tyre të plotë kognitiv dhe fizik.
- e. Përfshirja dhe vendimmarrja e fëmijëve: Inkurajimi i përfshirjes së fëmijëve në vendimmarrje që i përket atyre, duke i dëgjuar dhe marrë parasysh mendimet dhe idetë e tyre.
- f. Ndërgjegjësim dhe edukim: Sensibilizimi i komunitetit për rëndësinë e të drejtave të fëmijës dhe përgatitja e fëmijëve për të ndërgjegjësuar veten për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.
- g. Krijimi i një mjedisi të sigurtë dhe mbështetës: Përmirësimi i mjedisit të përgjithshëm për fëmijët në komunë, duke garantuar sigurinë dhe ndihmën e nevojshme për zhvillimin e tyre.
- h. Zhvillimi i kapaciteteve dhe bashkëpunimi: Ngritja e kapaciteteve të profesionistëve që punojnë me fëmijët dhe bashkëpunimi me organizatat lokale dhe ndërkombëtare për të fuqizuar efektivitetin e veprimeve për të drejtat e fëmijëve.
- i. Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit: Krijimi i një sistemi të përhershëm për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të masave dhe veprimtarive të planit të punës për të drejtat e fëmijës.

Qëllimi i EDF-së në Komunën e Gjakovës është të krijojë një mjedis të favorshëm për rritjen e sigurtë dhe të shëndetshme të fëmijëve, zhvillimin e potencialit maksimal fizik dhe psikosocial të tyre, përfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen aktive në të gjitha fushat që prekin jetën e tyre. Mekanizmi menaxhues për monitorimin e këtij plani të veprimit, i krijuar nga EDF synon garantimin e vlerësimit të progresit të të drejtave të fëmijës në fushat kryesore politikbërëse që lidhen me fëmijët.

Ky qëllim synohet të realizohet përmes:

1. Nxitjes së llogaridhënies, planifikimit, koordinimit, dhe monitorimit në nivel komunal dhe
2. Krijimit të një komune gjithëpërfshirëse.

Plani i Punës së EDF është dokument që ka marrë përbazë pikëpamjen e fëmijës përmes këtyre hapave: 1. KKGJ ka emëruar si vëzhgues të EDF dy përfaqësues të fëmijëve nga Asambleja Komunale e Fëmijëve në Komunën e Gjakovës dhe 2. Duke lejuar pjesëmarrjen e gjerë të tyre në diskutim dhe dhënien e ideve dhe mendimeve të tyre të pasqyruara në këtë dokument.

Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën. Kjo përfshin të drejtën për të jetuar në një planet të pastër dhe të shëndetshëm, në një mjedis mbrojtës, për tu çlodhur, për të luajtur dhe për të shijuar aktivitete kulturore dhe artistike dhe për të shijuar dhe respektuar mjedisin natyror.

Komuna e Gjakovës – Profili

Gjakova është ndër qytetet me sipërfaqen më të madhe në Kosovë me 586 km². Ndodhet në pjesën Jug-Lindore të Rrafshit të Dukagjinit dhe në pjesën Jug-Perëndimore të Kosovës. Shtrihet ndërmjet lumenjve “Ereniku”, “Drini”, “Krena” e “Llukaci”, është e pasur me shumë burime natyrore dhe njerëzore, si dhe është e vendosur në mes të maleve dhe bjeshkëve të Nemuna, Pashtrikut, Mokra Gora dhe Sharrit në Jug-Perëndim. Liqeni i Radoniqit është në funksion që nga viti 1985 me një kapacitet maksimal prej 117 milion m³ deri në kuotën mbidetare 456m¹².

Komuna e Gjakovës administron 88 fshatra me një popullsi të përgjithshme prej 94,556 banorësh, ndërsa bazuar në vlerësimet e popullsisë për vitin 2021 Gjakova shënoi rënie për 1.83% duke rënë numri i banorëve në 93,740 me densitet mesatar të popullsisë prej 159 banor për metër katror¹³.

Gjakova përfaqësohet me etnicitet shumicë shqiptare dhe një përfaqësim të konsiderueshëm të grupit etnik të egjiptianëve, romëve dhe ashkalinjëve të Kosovës prej 6,468 banorësh, të cilët përbëjnë 7% të popullsisë në komunën e Gjakovës.

Fëmijë dhe të rinjë deri në moshën 19 vjeçare në komunën e Gjakovës janë 35,753 sosh me një balancë gjinore pothuaj të barabartë¹⁴.

¹² Plani Zhvillimor Komunal, 2021-2029, Komuna e Gjakovës

¹³ Letërnjoftimi i Komunave, Gjakova 2021, GAP

¹⁴ Profili i Komunave, MAPL

MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËS NË KONTEKSTIN GLOBAL, NACIONAL DHE LOKAL

Kushtetuta e Kosovës, në nivel të përgjithshëm përcakton mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kapitulli II i kushtetutës rregullon të drejtat dhe liritë themelore duke rregulluar zbatimin e marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën për të Drejtën e Fëmijës. KDF u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara përmes rezolutës 44/25, me 20 nëntor 1989. Konferenca Botërore mbi të Drejtat e Njeriut në Vjenë deklaroi se qëllimi ishte ratifikimi universal i kësaj konvente deri në fund të vitit 1995. Më 31 dhjetor 1995, jo më pak se 185 shtete e ratifikuan konventën.

KDF vendos standardet themelore duke mundësuar që çdo shtet të gjejë mënyrat që zbatimi i të drejtave të fëmijës të bëhet bazuar në kulturën, gjendjen ekonomike dhe sociale që i përket.

Janë katër parime të përgjithshme të ruajtura në konventë që rrjedhin nga nenet 2,3, 6 dhe 12:




Fig.1 Parimet e përgjithshme të KDF

Më 24 Mars 2021, Komisioni Evropian miratoi përmbajtjen e Strategjisë së EU për të drejtat e fëmijëve, sikurse edhe një propozim për ti rekomanduar këshillit ngritjen e një Garancie Evropiane për Fëmijët për të promovuar mundësi të barabarta për fëmijët në rrezik varfërie ose përjashtimi social.

Me përfundimin e periudhës së Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit në vitin 2015, liderët botëror në Kombet e Bashkuara lansuan zyrtarisht Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm në vitin 2016. Kjo agjendë promovon 17 objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm për të transformuar botën deri në vitin

2030¹⁵. Kuvendi i Republikës së Kosovës me dt: 25 Janar 2018 ka miratuar rezolutën Nr 06-R-001 Për Miratimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (ose agjendën 2030).

Nga këto 17 objektivat e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, ky plan i punës për të drejtat e fëmijëve ndërlidhet me objektivin OQZH 1 – Fundi i varfërisë në të gjitha format e saj kudo, OQZH-2 – Zero uri, OQZH 3- Shëndet i mirë dhe mirëqenie, OQZH 4-Arsim cilësor, OQZH 5-Barazia gjinore, OQZH 8-Punë e denjë dhe rritje ekonomike, OQZH 10-Reduktimi i pabarazive, OQZH 16-Paqe, drejtësi dhe institucione të forta, etj.

Në Kosovë, kemi ligjin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, i cili ndjek parimet e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe tregon rolin e institucioneve në mbrojtjen e fëmijëve, krijimin e mekanizmave të përshtatshëm dhe masat mbrojtëse. Gjatë hartimit të strategjisë, ky ligj është konsultuar dhe shumë masa janë hartuar në përputhje me të. Natyrisht, konteksti lokal ka përcaktuar aspekte të veçanta të organizimit, si krijimi i një mekanizmi koordinator.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim është një dokument kyç në procesin e hartimit të strategjisë dhe planit të veprimit për fëmijë. UNICEF ka publikuar një dokument me titullin "Një agjendë për fëmijë", i cili kontribuon në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 dhe promovon zhvillimin ekonomik dhe social të qëndrueshëm duke përmirësuar të drejtat e fëmijëve.

Në nivelin komunal, UNICEF ka përkrahur hartimin e Strategjisë dhe Planin e Punës për Komunën Mike në Komunën e Gjakovës (2017-2021), gjithashtu përkrah themelimin e EDF sipas legjislaturës në fuqi dhe vazhdon të përkrahë hartimin e këtij plani dhe matricën e planit si vazhdimësi e planit strategjik paraprak.

Vlerat që synon ky plan:

-  Ndikimi në jetën e fëmijëve, përmes përmirësimit të cilësisë së shërbimeve në të gjitha nivelet,
-  Promovimi i një kulturë të të drejtave të fëmijëve dhe të hedhë bazat për pjesëmarrje kuptimplotë të fëmijëve në Komunën e Gjakovës,
-  Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës,
-  Sigurimi i të dhënave cilësore në funksion të përmirësimit të politikave dhe programeve të hartuara për ta,
-  Realizimi i edukimit në funksion të mbrojtjes së fëmijëve, duke garantuar kështu mirëqenien dhe një të ardhme më të mirë për fëmijët.

Këto vlera të synuara nuk kanë afat kohor, do të jenë vazhdimësi e punës së përditshme të çdo akteri të involvuar.

¹⁵ <http://www.un.org/sustainabledevelopment/sustainable-development-goals/>

METODOLOGJIA DHE PROCESI

Plani i Punës i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës është hartuar duke u bazuar në UA (QRK) NR 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit në përputhje me Ligjin NR. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës dhe UA (QRK) NR. 06/2022 për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës dhe në frymën e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, Kushtetutës së Kosovës, Strategjisë së Bashkimit Evropian (BE) për të Drejtat e Fëmijës, udhërrëfyesve të UNICEF-it dhe dokumenteve tjera relevante për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijës.

Ky dokument ka filluar të hartohet nga Ekipi Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës i udhëhequr nga Kryesuesi i EDF Kryetari i Komunës zt. Ardian Gjini dhe zv. Kryesuesja e ekipit znj. Adelina Shehu Kola në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me të gjithë anëtarët e ekipit dhe vëzhguesit mbështetur nga këshilltarë të jashtëm nga UNICEF.

Plani është zhvilluar përmes procesit të konsultave të akterëve të sektorëve të ndryshëm duke përfshirë përfaqësues nga sektorët relevante në kuadër të DSHMS, DKA, QKMF, DKRS, DBF, QPS, MAPL, Ombudsperson-in dhe institucione tjera të angazhuara për të drejtat e fëmijës, përfshirë OJQ-të lokale, të huaja, etj. ndërsa grumbullimi i të dhënave u bë përmes takimeve me zyrtarë dhe ekspertë në vendpunimet përkatëse, nga regjistrimet lokale dhe vrojtimi.

Janë mbajtur dy takime në formë të punëtorisë nga Ekipi për Mbrojtjen e Fëmijës, mbështetur nga UNICEF nga ku janë nxjerr konkludimet e këtij plani.

Gjatë procesit është përdorur qasja analitike e të dhënave nga ku janë nxjerr analiza të përmbajtjes nga legjislacioni në fuqi si dhe dokumenteve të ndryshme: *Ligji NR. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës*, *Plani zhvillimor komunal për Komunën e Gjakovës (2021-2029)*, *Plani i zhvillimit institucional i kujdesit parësor shëndetësor të Gjakovës (2021-2024)*, *Plani i punës së komisionit për edukim dhe promovim shëndetësor në rritjen e shkallës së imunizimit të rregullt, me theks të veçantë tek komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian (2022-2024)*, *Plani zhvillimor i arsimit (2017-2021)*, *Hartëzimi i shërbimeve të zhvillimit në fëmijërinë e hershme në Kosovë (Dhjetor, 2020)*, *Vizitat sistematike të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme të ulta, Klasa I, V dhe IX në komunën e Gjakovës, (QKMF, 2023)*, *Strategjia dhe plani i veprimit për komunën mike për fëmijët, KGJ (2017-2021)*, etj.

Plani i Punës i EDF kalon në fazat: Dëgjimi publik dhe votimi nga AK.

ANALIZA E SITUATËS DHE TREGUESIT SOCIAL

Arsimi

Kujdesi i hershëm lidhet ngushtë me shërbimet cilësore që ofron arsimi dhe edukimi i fëmijës.

Analiza e situatës në fushën e arsimit mbështetet në të dhënat e ofruara nga DKA si dhe nga pikëpamjet e zyrtarëve pjesëmarrës në punëtorinë për EDF.

Komuna e Gjakovës ka Institucionin Parashkollor ‘Ganimete Tërbeshi’ e cila ka nën menaxhim 6 njësi që shtrihen në zonën urbane dhe 1 njësi në fshatin Novosellë. Ky institucion ka kapacitet për të regjistruar 533 fëmijë¹³ ndërsa 52 mësimdhënës janë të punësuar për të ofruar shërbimet cilësore në 26 klasa të ndara në 4 grupmosha. 57 fëmijë janë të regjistruar në edukimin e hershëm të integruar në shkolla në zonat rurale, ndërsa në tërësi janë 819 fëmijë që ndjekin edukimin parashkollor në KGJ. Komuna e Gjakovës me mbështetje të MASHT synon të zgjerojë shtrirjen e njërive të IP rrjedhimisht duke ofruar shërbimet për parashkollorë për më shumë se 80% e të gjithë fëmijëve në Komunën e Gjakovës¹⁶.

Për vitin shkollor 2022/2023 në komunën e Gjakovës, 46 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta (1 SHFMU private) kanë regjistruar 10,487 nxënës nga të cilët 1358 janë të komuniteteve jo-shumicë dhe 6 shkolla të mesme të larta (2 shkolla të mesme private) kanë regjistruar 3396 nxënës prej të cilëve 132 janë të komuniteteve jo-shumicë. Nga SHML në komunë aktualisht janë 2 paralele të ndara të institucioneve publike të arsimit të mesëm të lartë të cilat shtrihen në zonat vijuese rurale: Cermjan dhe Rogove.¹⁷

IP 'Ganimete Terbeshi'	Shkolla Fillore dhe të Mesme të Ulëta	Shkolla të Mesme të Larta	Personeli
•7 njësi •533 nxënës	•47 shkolla •10,487 nxënës •1358 nxënës nga komuniteti jo-shumicë	•8 shkolla •3396 nxënës •132 nxënës nga komuniteti jo-shumicë	•1190 specialistë të arsimit •214 Punonjës teknik •96 punonjës në administratë

Trendi i trajektores tregon rënie të numrit të nxënësve prej 32% nga viti 2008/2009 deri 2019/2020, ndërsa numri i mësimdhënësve nga viti 2013-2022 ka rënë për 1% (289 më pak)¹⁸.

Raporti nxënës-mësimdhënës në nivelin parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët arsimor është 14 ndërsa në nivelin e arsimit të mesëm të lartë është 15.

Bazuar në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021, u bë vlerësimi i gjendjes ekzistuese nga ku synohet që 1/3 e nxënësve të mësojnë në një ndërrim. Në Komunë aktualisht nga të gjitha institucionet e arsimit fillor, të mesëm të ultë dhe të lartë, në 9 institucione të arsimit fillor dhe të mesëm të ultë mësimi zhvillohet në një ndërrim. Gjersa sipas Strategjisë Zhvillimore Socio-Ekonomike Lokale (SZHSEL) 2016-2018 të miratuar nga Komuna e Gjakovës është paraparë

¹⁶ Statistika nga DKA nga regjistrimet e vitit shkollor 2022/2023

¹⁷ Statistika nga DKA nga regjistrimet e vitit shkollor 2022/2023

¹⁸ Letërnjoftimi i Komunave, Gjakova 2021, GAP

organizimi i mësimit gjatë tërë ditës, kështu nevojitet vlerësim i kapaciteteve ekzistuese hapësinore në raport me Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor dhe trendit të numrit të nxënësve.

Duke u bazuar në Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor:

Distanca/rrezja optimale shërbyese në vijë ajrore	Vlerësimi i rrezës së mbulueshmërisë (mungesë)
Për çerdhe/kopshte urbane – 300/500 m	Blloku i Ri, zona e Çarshisë së madhe dhe Dardani
SHFMU - Urbane 1,500 m SHFMU - Rurale 1,900 m	Brekoc Plotësohet kriteri i mbulueshmërisë
SHML – Urbane 1,500 m SHML – Rurale 4,700 m	Dardani Skivjan

Bazuar në të dhënat e mësipërme, në komunën e Gjakovës mungojnë institucione publike parashkollore në lagjet urbane Brekoc, Blloku i Ri, Dardani dhe Rezinë, mungojnë institucione publike të arsimit të mesëm të lartë në lagjen urbane Dardani¹⁹.

Sipas UA Nr.34/2014 për Funkcionimin Pedagogjik-Psikologjik nëpër Shkolla, Komuna e Gjakovës ka mbuluar të gjitha shkollat në nivelin urban me bashkëpunëtorë profesional-psikolog/pedagog, ndërsa në nivelin rural janë mbuluar 3 zonat gjeografike sipas këtij udhëzimi që citon: 1000 nxënës marrin shërbime nga 1 bashkëpunëtor profesional -psikolog/pedagog duke ngritur numrin në 12 sosh nga 2 psikolog që ishin në vitin 2022. Zona e Rekës së Keqe ka mungesë të bashkëpunëtorëve profesional.

Janë të identifikuar më shumë se 103 fëmijë me nevoja të veçanta (fëmijë me aftësi të kufizuara fizike apo mendore dhe fëmijë me vështirësi në të nxënë²⁰) prandaj bazuar në vlerësimet profesionale janë të punësuar 18 asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta mbështetur nga mësues mbështetës në të gjitha shkollat urbane dhe 4 asistentë në shkollat rurale sipas nevojës së paraqitur. Nga këto 22 asistentë, 16 asistentë mbështeten nga UNICEF-zyra në Kosovë në partneritet me FKZH-në me kontrata 18 muajshe. Pas përfundimit të kontratave të këtyre asistentëve, bëhet vlerësimi i situatës së fëmijëve me nevoja të veçanta dhe punësimi përkitazi me vlerësim duke u bazuar në udhëzimin për gjithëpërfshirje ku citon: 1 asistent për 3 fëmijë.

Bazuar në trendin e rritjes së numrit të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe pas hulumtimit të nevojave të shkollave në KGJ, hulumtim i kryer nga UNICEF, u shfaq nevoja për klasa burimore në dy shkollat më të mëdha të qytetit: SHFMU ‘Zekeria Rexha’ dhe SHFMU ‘Emin Duraku’. UNICEF financon krijimin e këtyre 2 klasave për shfrytëzim gjatë vitit shkollor 2023/2024.

Trendi i rritjes së numrit të fëmijëve me nevoja të veçanta si dhe sfidat në identifikim, pranim dhe intervenim të hershëm të këtyre fëmijëve shpërfaq nevojën emergjente për realizimin e një studimi fizibiliteti në lidhje me nevojën për qendër burimore në Komunën e Gjakovës.

Në Komunën e Gjakovës do të fillojë instalimi i sistemeve fotovoltaike, përfitues do të jenë shkollat e përzgjedhura me shpenzimet më të larta të energjisë elektrike. Ky projekt financohet nga KFOS²⁰.

¹⁹ Plan i Zhvillimit Komunal, 2021-2029

²⁰ Statistika nga DKA nga regjistrimet e vitit shkollor 2022/2023

Shëndetësia

Kujdesi shëndetësor në komunën e Gjakovës përbëhet nga një rrjet i gjerë i institucioneve, që janë të shtrira në gjithë territorin e komunës, përfshirë qytetin dhe 4 regjione gjeografike të pjesës rurale të komunës, e cila përbehet nga infrastruktura vijuese: 1 Spital Regjional; 1 Qendër Kryesore Mjekësore Familjare; 10 Qendra Mjekësore Familjare; dhe 15 Ambulante Mjekësore Familjare.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2017 - Organizmi, struktura, përcaktimi i shërbimeve dhe veprimtarisë së KPSH-së si dhe praktikën e kaluar në Republikën e Kosovës, Komuna ka kompetencë të ofrojë shërbimet e Kujdesit Parësor Shëndetësor (KShP) sipas kriterëve vijuese²¹:

Kriteret Minimale	Kriteret minimale për nr. e banorëve në KGJ	Gjendja aktuale
1 Amf për 2000 banorë	10 AMF	15 AMF
1 QMF për 10,000 banorë	8 QMF	10 QMF
1 QKMF për 100,000 banorë	1 QKMF	1 QKMF
1 mjek familjar dhe 2 infermierë për 2000 banorë	50 mjek 100 infermierë	73 mjek 207 infermierë
1 stomatolog për 6000 banorë	17 stomatolog	52 stomatolog

Rrjedhimisht, bazuar në numrin aktual sipas vlerësimeve të numrit të banorëve në Gjakovë për 93,740 banorë që jetojnë në komunë DSHMS plotëson kriteret për numrin e punonjësve/shërbimeve.

Numri i madh i burimeve njerëzore në kujdesin parësor krijon hapësirë të bollshme për ofrim të shërbimeve cilësore shëndetësore, duke përfshirë ekipin për shërbime cilësore të vizitave në shtëpi, ekipin e kujdesit ante/peri dhe post-natal dhe ekipin e imunizimit/vaksinimit.

Programi i Vizitave në Shtëpi në KGJ ka filluar nga viti 2016²² me mbi ~4,000 vizita të realizuara te fëmijët 0-3 vjeç. Mbi 60 punonjës janë trajnuar për këtë program.

Sipas raportit nga Ekipi i Programit të Vizitave në Shtëpi, vetëm në vitin 2023 deri në fund të Korrikut janë zhvilluar 1736 vizita për nënat dhe fëmijët 0-3 vjeç, ndërsa 234 vizita për gratë shtatzëna. Në vazhdim të takimeve, janë vizituar 204 familje nga komunitetet jo-shumicë.

Përqindja e fëmijëve që në moshën: 24–35 muaj kanë marrë të gjitha vaksinat themelore në cilëndo kohë para anketës, dhe 24–35 muaj kanë marrë të gjitha vaksinat e rekomanduara në kalendarin kombëtar të imunizimit është 88.1 % dhe 72.5%, derisa te komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian ishte 59.2%. Situata pandemike COVID-19 mund ta ketë përkeqësuar gjendjen e vaksinimit të fëmijëve sidomos fëmijët e komuniteteve jo-shumicë.

QKMF nën mbikqyrjen e drejtpërdrejtë të DSHMS-së dhe DKA-së, organizon vizita sistematike nëpër shkollë. Qëllimi i këtyre vizitave është vlerësimi i rritjes dhe zhvillimit psiko-fizik të grupmoshave të klasave të para, të pesta dhe të nënta në të gjitha SHFMU-të në KGJ. Përfitues të këtij projekti janë 3011 nxënës gjatë vitit shkollor 2022/2023²³. Nuk janë të përfshirë në vizitat sistematike fëmijët e nivelit parafillor, pasi që janë në fazën kyçe të zhvillimit dhe nevojitet interpretime të detajuara mbi gjendjen e tyre para fillimit të programit shkollor.

²¹ Plan i Zhvillimit Institucional i Kujdesit Parësor Shëndetësor të Gjakovës, 2021-2024

²² Profili i Komunave-Gjakovë, UNICEF

²³ Vizitat sistematike të nxënësve të shkollave fillore dhe shkollave fillore të mesme të ulëta në KGJ, 2023

Ankesat dhe rastet e shumta të raportuara në lidhje me dukuritë negative (përdorimi i dhunës, duhanit, substanca narkotike, etj.)²⁴ japin sinjale alarmante për mundësinë e hapjes së një qendre rehabilitimi për fëmijë (Qendra për Kujdes ndaj Fëmijës).

Mirëqenia Sociale

Komuna e Gjakovës ka gjithsej 4 hapësira të mirëqenies sociale si vijon: Qendra për Punë Sociale, Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Gjakovës "Hendikos Gjakova", Shoqata e shurdhmemecëve, dhe Shoqata e të verbërve.²⁵

Në mars të vitit 2021 ishin 4,251 anëtarë të familjeve nga Gjakova në skemën e ndihmës sociale. Nëse e krahasojmë me të dhënat e vlerësimit të popullsisë në fund të vitit 2019 del se 5% e banorëve të Gjakovës janë në skemën e ndihmës sociale. Trendi i familjeve me asistencë sociale shkon në rritje.

Gjatë vitit 2022 rreth 780 fëmijë kanë marrë shërbime nga QPS, ndërsa në gjashtë mujorin e parë për vitin 2023 janë shërbyer 515 fëmijë përfshirë edhe 149 fëmijë me aftësi të kufizuara si përfitues së skemës FAKP.




Fig.2 Statistikat e fëmijëve që marrin shërbime nga QPS-Gjakovë për vitin 2022²⁶

Në këto statistika hasim në raste që përfshijnë cenimin e të drejtave të fëmijës, kategori e rëndësishme për viktimë trafikimi dhe abuzim seksual.²⁷

Shërbimet e familjeve strehuese i ofrojnë 6 familje në rajonin e Gjakovës dhe 4 familje janë ofruar potencialisht për adoptim.

Në Komunë aktualisht 780 banorë pranojnë ndihmë sociale, ku pjesa dërmuese prej 68.21% janë persona me sëmundje trupore ose aftësi të kufizuara fizike, 20.38% janë persona me aftësi të kufizuara mendore, 6.79% janë fëmijë pa përkujdesje prindërore, 3.21% janë persona me marrëdhënie të çrregulluara në familje, 1.15% janë viktimë të dhunës në familje dhe 26% janë viktimë të trafikut të qenieve njerëzore.

²⁴ Të dhëna nga DSHMS

²⁵ Plani Zhvillimor Komunal, 2021-2029

²⁶ Bazuar në raportin vjetor të QPS-Gjakovë

²⁷ Të dhëna nga QPS-Gjakovë

Është vërejtur mungesë e institucioneve të mirëqenies dhe përkujdesjes sociale si strehimore e përkohshme për persona të pastrehë/qendër rehabilitimi, qëndrim i përkohshëm ditor për fëmijë me nevoja të veçanta/qendër burimore, qendër për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve nga dhuna²⁸.

Kultura, Rinia dhe Sporti

Fëmijët/të rinjtë nuk kanë mundësi të drejtpërdrejtë të ndikojnë në politikën komunale sepse nuk kanë të drejtë të votojnë. Sipas nenit të dymbëdhjetë të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, çdo fëmijë ka të drejtë të krijojë mendimin e tij dhe ta shprehë këtë në çështjet që kanë të bëjnë me fëmijën. Këshilli rinor duhet të ketë mbledhje të rregullta. Qëllimi është që të ketë përfaqësues nga këshillat e nxënësve të të gjitha shkollave të komunës (përfshirë shkollat e pavarura) në shkollat fillore dhe të mesme. Këshilli është një mënyrë që komuna të marrë pjesë në mendimet e të rinjve në punën komunale. KVRL do të funksionojë si organ referues për çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët, do të rrisë mundësinë e fëmijëve për të ndikuar në zhvillimin në komunë dhe do të jetë në gjendje t'i jetësojë pyetjet në komisione dhe në kuvendin komunal.

Në Komunë janë gjithsej 12 institucione kulturore si vijon: 4 Muze; 1 Pallat të kulturës; 1 Teatër; 1 Kinema; 1 Bibliotekë; 2 Shtëpi të Kulturës dhe një shtëpi të kulturës në ndërtim e sipër.

4 hapësira sportive dhe rekreative si vijon: 1 Pallat i Sporteve; 1 Stadiumi i Qytetit; 1 Fushë e futbollit; 1 Fushë e tenisit në ndërtim e sipër²⁹.

Muzeu i Historisë, Muzeu Etnografik, Muzeu i Muzikës, Muzeu i martirëve Qerkezi.

Mungojnë fusha të hapura sportive dhe rekreative në zonën urbane dhe në vendbanimet me më shumë 1,000 banorë si: Jahoc, Damjan, Brekoc, Gërçinë, Osek Hilë, Bec, Kralan, Cermjan dhe Qerim.

Qendra me interes për vizitë:

-  Shpella e Arushës
-  Shpella e Qirave
-  Shpella e Xhytezes
-  Shpella e Kusarit

Biblioteka ofron të gjitha shërbimet e nevojshme për fëmijë, në vitin 2022 kanë qenë gjithsej 603 lexues kurse në periudhën janar-shtator janë 567 lexues. Kjo ramje e lexuesve është si rezultat i ngarkesës së madhe me planprogramet shkollore.

²⁸ Plan i Zhvillimor Komunal 2021-2029 Komuna Gjakovë, fq.112

²⁹ Draft-Harta Zonale e Komunës 2022-2030

Mjedisi dhe hapësirat e gjelbra

Në vitin 2020, KRM “ÇABRATI” Sh.A., planifikon të involvohet në procesin e riciklimit duke krijuar oborret/linjat e riciklimit për asgjësim dhe trajtimin dytësor të pjesëve të thata të mbeturinave. Ky lokacion do të shërbejë për përzgjedhjen shtesë të mbeturinave të deponuara, paketimin e tyre dhe dërgimin e mëtutjeshëm në treg. Pra, riciklimi i mbeturinave është i vogël dhe si rezultat i saj menaxhimin dhe grumbullimin i mbeturinave është shumë më i vështirë, pra mungon ndarja e mbeturinave në burim. Shkala e riciklimit është rreth 5% dhe planifikohet që në një periudhë të shkurtër të rritet deri në 23%.

Bicikleta mbetet një mjet i preferuar dhe mjaft i përdorur në qytetin e Gjakovës, por hapësirat për lëvizje me biçikleta nuk janë të mjaftueshme. Pikërisht, shtigjet për ciklist janë një ndër problemet kryesore në qytetin e Gjakovës. Në shumë pak zona të qytetit ka shtigje të shënuara për çiklist, ndërsa edhe në ato vende ku mund të lëvizin biçikletat.

Pas identifikimit të këtyre problematikave, janë propozuar investimet në këto fusha të paraqitura në shtojcë si matrica e planit të punës, bazuar në dokumentet: draft-Harta Zonale e Komunës 2022-2030³⁰ dhe Plan i Zhvillimor Komunal 2021-2029, Gjakovë³¹.

Në Komunë janë gjithsejt 9 hapësira të hapura publike si vijon:



Fig.3 Hapësira të hapura publike

Në bazë të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, Nr.03/L-025, Ligjit i mbrojtjes së ajrit nga ndotja, Nr.03/L-160 dhe Ligjit për veprimtarinë hidrometeorologjike, Nr.02/L-79, IHMK është i obliguar që të bëjë monitorimin e cilësisë së ajrit në tërë territorin e Kosovës. Por në territorin e komunës së Gjakovës nuk ka pika monitoruese të cilësisë së ajrit, andaj në një të ardhme të afërt do duhej të vendosen instrumente monitoruese në disa pika.

³⁰ <https://kk.rks-gov.net/gjakove/wp-content/uploads/sites/2/2023/02/Draft-Harta-Zonale-e-Komunes-Shqyrtimi-Publik.pdf>

³¹ <https://kk.rks-gov.net/gjakove/wp-content/uploads/sites/2/2020/12/Draft-Plani-Zhvillimor-Komunal-2021-2029.pdf>

Ekipi për të Drejtat e Fëmijës

EDF sipas vendimit nr. 20974 përbëhet nga: 1. Kryetari i Komunës së Gjakovës zt. Ardian Gjini-Kryesues i Ekipit, 2. Adelina Shehu-Kolaj, Drejtoreshë për DSHMS, zv. Kryesuese e Ekipit, 3. Eranda Kumnova-Baçi, Drejtoreshë për Arsim-anëtare, 4. Dafina Kazazi-Olloni, Udhëheqëse e Sektorit të Shëndetësisë-anëtare, 5. Adea Roka, Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport-anëtare, 6. Durim Halilaj, Drejtor për Buxhet dhe Financa-anëtar, 7. Mimoza Shala, Komiteti për Politikë dhe Financa-anëtare, 8. Liranda Dahsyla, Komuniteti për Komunitete-anëtare, 9. Lumniye Shllaku, Njësia për të Drejtat e Njeriut-anëtare, 10. Lukë Përlalaj, zyrtar i Policisë në Gjakovë-anëtar, 11. Dervish Tahiri, Drejtor i Qendrës për Punë Sociale-anëtar, 12. Berat Thaqi, Përfaqësues i Shoqërisë Civile-anëtar.

Në cilësinë e vëzhguesve: 1. Diella Hana dhe 2. Arsa Saraqini, përfaqësuese nga Asambleja e fëmijëve, 3. Linda Dula Halilabazi, përfaqësuese e Këshillit të Prindërve, 4. Nora Shehu Bunjaku, përfaqësuese nga organizata jo-qeveritare.

Në cilësinë e këshilltarëve të jashtëm: 1. Dren Rexha dhe Edona Lipoveci, UNICEF³².

EDF takohet së paku 4 herë në vit në takime të rregullta dhe më shumë sipas nevojës.

EDF fuqizon mekanizmat bashkëveprues lidhur me çështjet e të drejtave të fëmijës në Komunë.

EDF sigurohet për mbarëvajtjen e këtij plani, bën monitorimin dhe rishikimin e zbatimit të planit në baza vjetore bazuar në vetë-vlerësimet komunale.

EDF si mekanizëm kordinues i përgjigjet drejtpërdrejt Kryetarit të Komunës.

Detyrat e mekanizmit koordinues përfshijnë:

-  Sigurimin e koordinimit të politikave të cilat ndikojnë tek fëmijët,
-  Sigurimin e zbatimit të kornizës ligjore për të gjitha çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, brenda kompetencave të Komunës,
-  Mbështetjen e fuqishme në të gjitha çështjet e fëmijëve, dhe ndikimet në legjislacionin dhe politikat e vendit,
-  Vetë-vlerësimet periodike të cilat rezultojnë me veprime dhe politika që duhet të ndërmerren nga komuna në mënyrë që të krijohet një komunë mike për fëmijë,
-  Rishikimin e zbatimit të planit në baza vjetore, bazuar në vetëvlerësimin komunal,
-  Sigurimin e një sistemi komunikimi që mundëson shprehjen e mendimeve të fëmijëve, me pjesëmarrjen e fëmijëve, të cilat përfshihen në punën e qeverisjes në nivel komunal,
-  Sigurimin e një sistemi komunikimi që mundëson shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve komunale dhe qendrore,
-  Ofrimin e këshillave dhe rekomandimeve për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve,
-  Koordinimin e të gjithë trupave tjerë që merren me mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve.

³² Vendimi 01nr. 112/02-20974 i korrigjuar.

MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E PLANIT TË VEPRIMIT

VIZIONI I PLANIT TE VEPRIMIT

Synimi i planit të veprimit është krijimi i një strukture që ofron kushtet për të vepruar në përputhje me punën strategjike dhe afatgjatë për të drejtat e fëmijës dhe për të forcuar mundësitë e fëmijëve që të përfshihen në çështjet që i shqetësojnë përmes vizionit:



Gjakova, komunë ku promovohen dhe realizohen të drejtat e fëmijës, për arritjen e potencialit të tyre të plotë, në përputhje me standardet ndërkombëtare, kushtetutën dhe legjislacionin në Republikën e Kosovës.

Këtë vizion në nivel të fëmijëve synojmë të arrijmë duke:

- Rritur njohuritë e fëmijëve për Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe zbatimin e saj
- Fëmijët marrin pjesë në vendimet ku ata mund të jenë të përfshirë
- Ekziston një perspektivë e qartë për të Drejtat e Fëmijës në çdo vendimmarrje ku mund të jenë të përfshirë fëmijët.


MISIONI I PLANIT TE VEPRIMIT

Fuqizimi i sistemit të mekanizmave dhe shërbimeve cilësore dhe gjithëpërfshirëse komunale që mundëson mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijës, duke zhvilluar programe të cilat përveç mekanizmave, integrojnë dhe vet fëmijët në vendimmarrje.

Në mbështetje të vizionit të këtij dokumenti janë formuluar qëllimet kryesore strategjike me objektivat dhe masat përkatëse.

Objektivat Strategjike

Janë pesë fusha në të cilat mbështetet plani i punës i EDF. Këto fusha në asnjë mënyrë nuk mund të adresohen si të vetme. Përkundrazi ato janë të lidhura ngushtë në mes veti dhe e plotësojnë njëra-tjetrën.



Këto fusha prioritare, të përkthyer në objektiva strategjike përmbajnë masa që përmbushin këto objektiva, por njëkohësisht ndërlidhen me objektiva tjera duke i plotësuar këto, dhe duke e bërë koherente ndërmarrjen strategjike.

Si shembull shumë masa të fushës së vetëdijesimit dhe avokimit për fëmijë në mënyrë të drejtpërdrejtë e përmirësojnë ofrimin e shërbimeve për fëmijë. Prandaj, kudo që masa e një fushe ka lidhje të dukshme edhe me ndonjë fushë tjetër, do të bëhet një referencë e tillë.

Një fushë tjetër, ndërkaq, që lidhet me aspekte të koordinimit, vlerësimit dhe raportimit, është konsideruar si transversale. Masat që përmban kjo fushë i lidhin të gjitha fushat dhe shërbejnë si një lloj bazamenti i gjithë ndërmarrjes.

1. Përmirësimi i mbulueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore për nëna dhe fëmijë

Në kuadër të Planit të Punës së EDF, një prej qëllimeve kryesore është përmirësimi i mbulueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore për nëna dhe fëmijë në komunën tonë. Nëpërmjet hetimeve të thella të situatës dhe konsultimeve me ekspertë, kemi identifikuar disa hapa të rëndësishëm për të arritur këtë qëllim e të cilat janë:

1.1. Zbatimi i Programit të Vizitave në Shtëpi

Ky program kërkon një qasje të rregullt, përgjegjëse dhe të përshtatshme për të siguruar kujdesin dhe zhvillimin e mirë të fëmijëve në moshën e hershme. Komuna e Gjakovës përmes këtij programi synon të ndikojë pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve nëpërmjet përkrahjes dhe edukimit të prindërve, si dhe monitorimit të rregullt të gjendjes së fëmijëve

1.2. Zbatimi i Programit të Imunizimit të rregullt

Imunizimi është një nga mënyrat më të efektshme për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive dhe për të mbrojtur shëndetin e fëmijëve. Zbatimi i Programit të Imunizimit të Rregullt është një përpjekje thelbësore për të siguruar që fëmijët të jenë të mbrojtur nga sëmundjet potencialisht të rrezikshme. Ky program ka ndikim të gjerë në shëndetin publik dhe kontribuon në krijimin e një shoqërie më të shëndetshme dhe të sigurt për të gjithë

1.3. Zbatimi i Programit të Kontrolleve Sistematike Shëndetësore në shkolla

Programi i Kontrolleve Sistematike Shëndetësore në shkolla është një iniciativë e rëndësishme për të siguruar monitorimin dhe përmirësimin e shëndetit të fëmijëve gjatë kohës që ata janë në mjedisin shkollor. Kjo është një mënyrë e rëndësishme për të identifikuar dhe trajtuar herët çdo problem shëndetësor që mund të prekë fëmijët, si dhe për të promovuar ndërgjegjësimin e tyre për shëndetin dhe mirëqenien

1.4. Programi i Kontrolleve Sistematike Shëndetësore në shkolla

Programi i Kontrolleve Sistematike Shëndetësore në shkolla është një iniciativë e rëndësishme për të siguruar monitorimin dhe përmirësimin e shëndetit të fëmijëve gjatë kohës që ata janë në mjedisin shkollor. Kjo është një mënyrë e rëndësishme për të identifikuar dhe trajtuar herët çdo problem shëndetësor që mund të prekë fëmijët, si dhe për të promovuar ndërgjegjësimin e tyre për shëndetin dhe mirëqenien.

1.5. Programi i promovimit të edukimit shëndetësor dhe shëndetit mendor në shkolla fillore dhe të mesme

Programi ka për qëllim vetëdijësimin e të rinjëve për problematika të shëndetit mendor dhe ndërlihdjen e impaktit që kanë këto problematika me shëndetin fizik. përballjen sa më të lehtë të situatave të ndryshme me të cilat përballen ata.

2. Përmirësimi i mbrojtjes, sigurisë dhe mirëqenies sociale

Qëllimi kryesor i këtij objekti është të përmirësojë mirëqenien sociale të fëmijëve në mënyrë të qëndrueshme dhe të ndjeshme ndaj nevojave të tyre. Ky objektiv do të adresojë sfidat dhe mundësitë që fëmijët përballen në komunitetin tonë, dhe synon të ndërtojë një mjedis të përshtatshëm dhe të mbështetshëm për rritjen dhe zhvillimin e tyre. Disa qëllime specifike të këtij objekti janë:

2.1. Fuqizimi i programit të strehimit familjar, farefisnor dhe në institucione tjera

Familjet strehuese dhe farefisnore janë provuar të suksesshme, andaj Komuna e Gjakovës do të organizojë fushata informuese për publikun për rolin e familjes strehuese dhe farefisnore, identifikimin dhe trajnimin si dhe profilizimin e tyre përmes shkëmbimit të përvojave si dhe subvencionimin e tyre nga Qendra për Punë Sociale.

2.2. Ofrimi i shërbimeve sociale për fëmijët në nevojë

Ofrimi i shërbimeve për të gjithë fëmijët në nevojë është një synim kyç i këtij plani dhe ka për qëllim të sigurojë që çdo fëmijë, pa dallim, të ketë mundësi për të përfituar nga shërbimet dhe ndihmat e nevojshme për zhvillimin, mirëqenien dhe përfshirjen e tyre në shoqëri. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve për të gjithë fëmijët në nevojë ndikon në sigurimin e një shoqërie të drejtë duke kontribuar në zhvillimin e tyre të plotë dhe në ndërtimin e një të ardhme më të ndritshme. Kjo gjithashtu përkon me përpjekjet për të përmbushur qëllimet e trajtimit të drejtave të fëmijëve dhe për të krijuar një shoqëri më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse.

3. Zhvillimi i një sistemi arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës

Në kuadër të Planit të EDF, një prej synimeve kryesore është zhvillimi i një sistemi arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës. Ky synim ka për qëllim të sigurojë që të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh prejardhjen, gjininë, ose kushtet ekonomike, kanë mundësinë për arsimim dhe edukim cilësor duke ju ofruar mësimdhënie dhe mësimnxënie kualitative bashkëkohore, mjedis të përshtatshëm mësimor me infrastrukturë adekuate, gjithëpërfshirëse dhe qasje holistike.

Për t'u realizuar qëllimi i këtij objekti kemi paraparë disa masa të veprimit:

3.1. Përmirësimi i cilësisë dhe rritja e përfshirjes së fëmijëve në edukimin në fëmijëri të hershme

Kjo objektivi specifike synon përmirësimin e cilësisë së edukimit të hershëm dhe të rrisë nivelin e përfshirjes së fëmijëve në këtë proces të rëndësishëm. Kjo përfshin veprime të ndryshme për të siguruar një mjedis më të përgjigjshëm dhe të pasur me mundësi për zhvillimin e fëmijës në fazën e hershme të jetës. Përmirësimi i cilësisë së edukimit dhe rritja e përfshirjes së të gjithë fëmijëve ndikojnë në ndërtimin e një shoqërie më të informuar dhe të përparuar, ku secili fëmijë ka mundësi për të arritur potencialin e tij të plotë.

3.2. Përmirësimi i cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në arsimin fillor dhe të mesëm

Synimi për përmirësimin e cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në nivelet e ndryshme të arsimit është një përpjekje e vazhdueshme që përket me zhvillimin e një sistemi arsimor të efikasshëm dhe të drejtë për të gjithë studentët. Ky synim thekson rëndësinë e një arsimit cilësor dhe të qasshëm

për të gjithë, pavarësisht prej prejardhjes, statusit social, ose aftësive individuale. Në kuadër të kësaj mase përcaktohen: trajnimi i punonjësve të arsimit, digjitalizimi i mësimdhënies, përmirësimi i infrastrukturës shkollore, krijimi i programeve të përshtatshme dhe qasja multidisciplinare me bashkëpunëtorët profesional për nxënës të aftësi të kufizuara, zvogëlimi i numrit të nxënësve që braktisin shkollën, intervenimi i hershëm kundër dhunës, bullizmit dhe dukurive tjera negative, rrjeti për këshillimin dhe orientimin në karrierë.

3.3. Ngritja e cilësisë së sigurisë nëpër shkolla dhe institucione parashkollore

Siguria e lartë në shkolla dhe institucione parashkollore është thelbësore për të krijuar një mjedis të përshtatshëm për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve. Kjo objektive specifike synon të sigurojë që fëmijët, punonjësit dhe prindërit të ndjehen të mbrojtur dhe të sigurtë brenda këtyre ambienteve.

Në kuadër të kësaj objektive janë përcaktuar disa veprime për ofrimin e sigurisë në shkolla dhe IP e të cilat janë: pajisja e të gjitha shkollave me kutitë e ndihmës së parë, mirëmbajtja e sinjalistikave të dukshme brenda në shkollë dhe para hyrjeve të shkollave për siguri më të lartë dhe pajisja me jelek sinjalizues për të gjithë nxënësit e klasave të para dhe të dyta.

4. Ofrimi i programeve të edukimit jo-formal, sportit, rekreacionit dhe mbrojtjes së mjedisit

Në kuadër të Planit të Punës për të Drejtat e Fëmijëve, një qëllim i rëndësishëm është ofrimi i programeve të edukimit jo-formal, sportit, rekreacionit dhe mbrojtjes së mjedisit për të përmirësuar zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve në komunitetin tonë. Për të arritur këtë qëllim strategjik, janë përcaktuar masat si më poshtë:

4.1. Ngritja e njohurive dhe shkathtësive të rinjëve përmes edukimit jo-formal

Për të arritur këtë objektive janë përcaktuar aktivitete për fëmijët që kanë nevojë për mbështetje të veçantë në zhvillimin e aftësive. Kjo përfshin zhvillim të aftësive të ndryshme, si artistike, kulturore, teknologjike, shkathtësive të buta dhe kujdesja personale. Këto programe do të ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë potencialin e tyre dhe të pregaditen për jetën në shoqëri dinamike dhe përparimtare.

4.2. Promovimi i praktikave të shëndetshme dhe rritja e mirëqenies së fëmijëve dhe të rinjëve përmes aktiviteteve sportive dhe kulturore

Në kuadër të Planit, aktivitetet për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore për fëmijët kanë një rëndësi të jashtëzakonshme. Kjo trashëgimi është e pasur dhe unike për secilën kulturë dhe komunitet, dhe është e rëndësishme që fëmijët të njohin, respektojnë dhe ndihmojnë në ruajtjen e identitetit kulturor dhe historisë së tyre. Me aktivitetet e përcaktuara në këtë plan synohet zhvillimi i identitetit, ngritja e vetëdijes kulturore dhe forcimi i respektit dhe tolerancës. Pra, këto programe ndihmojnë në ndërtimin e një shoqërie të harmonizuar dhe të ndërgjegjshme për diversitetin. Aktivitetet sportive dhe rekreative të ndryshme për fëmijët përfshijnë turnire sportive në kategori të ndryshme, dhe aktivitete të tjera që nxisin aktivitetin fizik dhe bashkëpunimin. Këto aktivitete do të ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë aftësi fizike-motorrike, emocionale dhe sociale, ndërsa njëherazi promovojnë shëndetin dhe mirëqenien.

4.3. Ngritja e vetëdijësimit dhe angazhimi aktiv i fëmijëve dhe të rinjëve në mbrojtjen e mjedisit

Kjo objektivë synon ngritjen e përgjegjësisë ndaj natyrës, ndërgjegjësimin ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe ngritjen e vetëdijes së fëmijëve rreth rëndësisë së mbrojtjes së mjedisit.

Nëpërmjet angazhimit të tyre në programe të edukimit jo-formal, sportit, rekreacionit dhe mbrojtjes së mjedisit, fëmijët do të ndihen të përkrahur për të ndjekur ëndrrat e tyre dhe të kontribuojnë pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin e komunitetit tonë.

5. Fuqizimi i mekanizmit komunal për të Drejtat e Fëmijës

Në kuadër të këtij plani, objektiva e fuqizimit të mekanizmit komunal për të drejtat e fëmijëve ka për qëllim të ndërtojë një strukturë të fortë dhe të përshtatshme në nivel komunal për të siguruar respektimin dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në të gjitha fushat e jetës së tyre. Kjo objektivë do të përdorë përfshirje aktive të komunitetit dhe angazhim të institucioneve për të siguruar një ndryshim pozitiv dhe të qëndrueshëm në trajtimin e fëmijëve në nivel lokal.

5.1. Mbajtja e takimeve të rregullta të EDF

Takimet obligative çdo 3 muaj janë një praktikë e rëndësishme për të koordinuar veprimet dhe përpjekjet në fushën e të drejtave të fëmijëve. Kjo siguron që të gjithë anëtarët e ekipes ndajnë informacion, monitorojnë zhvillimet, ndajnë idetë dhe planifikojnë veprimet e ardhshme për të garantuar implementimin e planit në interesin më të lartë të fëmijës.

5.2. Trajnimet e politikbërësve dhe zyrtarëve komunalë për aspekte të të drejtave të fëmijëve

Ngritja e njohurive mbi të drejtat e fëmijës është e rëndësishme për të ndërgjegjësuar dhe përgatitur ata për të kuptuar dhe zbatuar me efikasitet politikat dhe veprimet që kanë ndikim në mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijëve. Këto trajnime mund të ndihmojnë në përmirësimin e qëllimeve dhe strategjive të qeverive vendore për të garantuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijëve.

5.3. Krijimi i një sistemi të menaxhimit të informacionit për fëmijët

Ky është një hap i rëndësishëm për të siguruar që të gjithë të kenë qasje në të dhënat dhe informacione në mënyrë të sigurtë, të drejtë dhe efikase. Kjo mund të përfshijë informacione lidhur me arsimimin, shëndetësinë, mbrojtjen, përfshirjen në vendimmarrje, dhe aspekte të tjera të ndikimit të politikave dhe veprimeve në jetën e fëmijëve.

5.4. Hartimi i një raporti vjetor për zbatimin e Planit të Punës të Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve është

Instrumenti mates do të jetë vetë-vlerësimi bazuar në fushat përkatëse të këtij plani. Ky hap lehtëson monitorimin e progresit të veprimeve të ndërmarra për të siguruar respektimin e të drejtave të fëmijës. Ky raport do të përmbajë informacion të detajuar mbi hapat e marrë, llogaridhënie, rezultatet e arritura dhe sfidat e hasura gjatë vitit të kaluar.

5.5. Përkrahja dhe fuqizimi i Asamblesë Komunale të Fëmijëve

Plani i punës përfshin idetë, mendimet dhe këndvështrimet e fëmijëve bazuar në nivelin perceptues të tyre. Përveç përfshirjes së dy anëtarëve të asamblesë Komunale të fëmijëve në EDF, takimet e rregullta do ju ndihmojnë që të zgjerohet këndvështrimi dhe asnjë fëmijë të mos mbetet prapa.

ORGANIZIMI, ZBATIMI DHE PËRGJEGJËSIA

Plani i punës i EDF mbulon të gjitha aktivitetet komunale në Komunën e Gjakovës, Organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare poashtu edhe kompanitë tjera.

Çdo kompani/OJQ në komunën e Gjakovës duhet të jetë në gjendje të veprojë sipas parimeve dhe rregullave të këtij plani apo/dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e fëmijës duke u kujdesur që të mbrohet interesi më i lartë i fëmijës sipas këndvështrimit dhe perspektivës së tyre.

EDF themelon mekanizmin kordinues për të drejtat e fëmijës i cili ka përgjegjësinë e përgjithshme për të siguruar që puna për të drejtat e fëmijëve ndiqet dhe zbatohet sipas planit të veprimit. Për të kryer një punë të qëndrueshme dhe të suksesshme për të drejtat e fëmijës, komuna duhet të punojë në bazë të strategjisë komunale dhe me qëllime afatgjatë. Ky plan i punës është komponent i rëndësishëm i kësaj çështje dhe funksionon si dokument udhëzues prandaj të gjitha organizatat, niveli politik, zyrtarë e qytetarë të thjeshtë kanë përgjegjësinë t'a zbatojnë atë.

Përfituesit e veprimeve janë fëmijët, dhe kjo përfshin çdo fushë të mundshme veprimi sektorial. Për më tepër, një nga synimet e këtij plani të punës lidhet me koordinimin dhe fuqizimin e përgjegjshmërisë institucionale për të adresuar çështjet e fëmijëve. Ky dokument është në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-084 'Për Mbrojtjen e Fëmijës', i cili përveçse ngarkon institucionet me përmbushjen e të drejtave bazuar në mandatin e tyre, përcakton edhe role të koordinimit ndersektorial në fushën e të drejtave të fëmijës.

Plani i veprimit është i plotfuqishëm pas miratimit nga AK.

BURIMET FINANCIARE

Ligji për financimin e pushtetit lokal siguron një alokim të bazuar në formulë të transfereve qendrore, për të siguruar parashikimin e të ardhurave komunale, si dhe një masë barazimi mes komunave.

Ky ligj i ndan transferimet në komuna në tri grante kryesore:

- a. një grant i përgjithshëm,
- b. një grant specifik për Arsimin dhe
- c. një grant specifik për Shëndetësinë.

Financimi për zbatimin e këtij plani të punës, bazuar në matricën e planit të punës bashkëlidhur me këtë dokument është parashikuar në buxhetin e komunës pas një vlerësimi të kostove indikative të thelluara të buxheteve egzistuese në përshtatje me qëllimin e politikave dhe zbatimin e objektivave strategjike në këtë plan.

Buxhetimi do të realizohet në mënyrë optimale dhe të qartë për programet për fëmijët dhe grupeve të ndryshme vulnerabël të tyre, duke bërë më transparente financimet për fëmijët në mënyrë për të siguruar të drejta të barabarta.

Efekti buxhetor do të jetë në të gjitha programet e Ministrive të linjës, që janë pjesë e këtij dokumenti.

PËRKUFIZIMET

Fëmija	Personat 0-18 vjeç
Perspektiva e fëmijëve	Perspektiva e fëmijës do të thotë që një i rritur e vendos veten në situatën e fëmijës sa më shumë që të jetë e mundur dhe përpiqet të kujdeset për interesin më të lartë të fëmijës. Bëhet fjalë gjithashtu për të bërë më të mirën për të kuptuar dhe respektuar përvojat, perceptimet dhe veprimet e fëmijëve.
Perspektiva e të drejtave të fëmijëve	Të marrë parasysh në çdo vendim apo veprim në lidhje me fëmijët, të mbështetet në të drejtat e tyre, në interesin më të lartë të fëmijës, parimin e barazisë, pikëpamjet e fëmijës, të drejtën e fëmijës për të jetuar dhe zhvilluar bazuar në kushtet dhe nevojat e veta, interesat e fëmijës në terma afatshkurtër dhe afatgjatë dhe se janë ndarë burime të mjaftueshme për të arritur të gjitha këto.
Fëmijë me aftësi të kufizuar	Nënkupton fëmijën me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata të cilat në ndërveprim me barrierat e ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tij të plotë dhe efektive në shoqëri, njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.
Mbrojtja e fëmijës	Nënkupton parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës, keqtrajtimit, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit, rrëmbimit, shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe punës së fëmijës në dhe jashtë shtëpisë.

SHTOJCAT

Matrica e Planit të Punës: Si dokument i ndarë